

MODELI I TRE LINJAVE TË IIA

Një përditësim i Tre Linjave të Mbrojtjes

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	1
PARIMET E MODELIT TË TRE LINJAVE	2
Parimi 1: Qeverisja.....	2
Parimi 2: Rolet e Bordit Mbikëqyrës	2
Parimi 3: Rolet e Drejtimit të Lartë dhe të linjës së parë dhe të dytë	3
Parimi 4: Rolet e linjës së tretë	3
Parimi 5: Pavarësia e linjës së tretë.....	3
Parimi 6: Krijimi dhe mbrojtja e vlerës	3
ROLET KRYESORE NË MODELIN E TRE LINJAVE	5
Bordi Mbikëqyrës	5
Drejtimi i lartë	5
Auditimi i brendshëm.....	6
Ofrues të jashtëm të sigurisë	6
Marrëdhëniet ndërmjet roleve kryesore	7
Ndërmjet bordit mbikëqyrës dhe drejtimit të lartë (si rolet e linjës së parë ashtu edhe të linjës së dytë)	7
Ndërmjet drejtimit të lartë (si rolet e linjës së parë ashtu edhe të dytë) dhe auditimit të brendshëm	7
Midis auditimit të brendshëm dhe bordit mbikëqyrës	9
Midis gjithë roleve.....	9
VËNIA NË ZBATIM E MODELIT	10
Struktura, rolet dhe përgjegjësitë	10
Mbikëqyrja dhe siguridhënia.....	11
Koordinimi dhe përafrimi	11

HYRJE

Organizatat janë sipërmarrje njerëzore, që veprojnë në një botë gjithnjë e më të pasigurt, komplekse, të ndërlidhur dhe të paqëndrueshme. Ato shpesh kanë palë interesi të ndryshme me interesa të ndryshëm, të ndryshueshëm dhe ndonjëherë konkurrues. Palët e interesit ia besojnë mbikëqyrjen organizative një organi qeverisës (bordi mbikëqyrës), i cili nga ana tjetër delegon burimet dhe autoritetin te drejtimi i lartë për të ndërmarrë veprime të përshtatshme, përfshirë administrimin e riskut.

Për këto arsye dhe më shumë, organizatat kanë nevojë për struktura dhe procese efektive për të mundur arritjen e objektivave, ndërsa mbështesin qeverisjen e fortë dhe administrimin e risqeve. Ndërsa bordi mbikëqyrës merr raporte nga drejtimi i lartë për aktivitetet, rezultatet dhe parashikimet, si bordi mbikëqyrës ashtu edhe drejtimi i lartë mbështeten në auditimin e brendshëm për të marrë siguri objektive, të pavarur dhe këshilla për të gjitha çështjet dhe për të promovuar dhe lehtësuar inovacionin dhe përmirësimin. Bordi mbikëqyrës është përgjegjësi kryesor për qeverisjen, e cila arrihet përmes veprimeve dhe sjelljeve të bordit mbikëqyrës, si dhe drejtimit të lartë dhe auditimit të brendshëm.

Modeli i Tre Linjave ndihmon organizatat të identifikojnë strukturat dhe proceset që ndihmojnë më mirë në arritjen e objektivave dhe lehtësojnë qeverisjen e fortë dhe administrimin e risqeve. Modeli zbatohet për të gjitha organizatat dhe optimizohet me anë të:

- Adoptimit të një qasje të bazuar në parime dhe përshtatjes së modelit në linjë me objektivat dhe rrethanat organizative.
- Përqëndrimin në kontributin që administrimi i riskut jep në arritjen e objektivave dhe krijimin e vlerës, si dhe në çështjet e "mbrojtjes" dhe ruajtjes së vlerës.
- Kuptimit të qartë të roleve dhe përgjegjësi të përfaqësuara në model dhe marrëdhëniet midis tyre.
- Zbatimit të masave për të siguruar që veprimtaritë dhe objektivat janë në përputhje me interesat prioritare të palëve të interesit.

Termet kryesore

Organizata – Një grup i organizuar i aktiviteteve, burimeve dhe njerëzve që punojnë në drejtim të realizimit të qëllimeve të përbashkëta.

Palët e interesit – Grupe dhe individë interesat e të cilëve shërbehen ose ndikohen nga organizata.

Organi drejtues (Bordi Mbikëqyrës) – Individët që janë përgjegjës përpara palëve të interesit për suksesin e organizatës.

Drejtimi i lartë – Individë, ekipe dhe funksione mbështetëse të caktuara për të siguruar produkte dhe / ose shërbime për klientët e organizatës.

Auditimi i brendshëm – Individë që veprojnë në mënyrë të pavarur nga drejtimi i lartë për të ofruar siguri dhe gjykim të thelluar mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e qeverisjes dhe administrimin e riskut (përfshirë kontrollin e brendshëm).

Modeli i Tre Linjave – Modeli i njohur më parë si Tre Linjat e Mbrojtjes.

Kontrolli i brendshëm – Proceset e krijuara për të siguruar besim të arsyeshëm mbi arritjen e objektivave.

PARIMET E MODELIT TË TRE LINJAVE

Parimi 1: Qeverisja

Qeverisja e një organizate kërkon struktura dhe procese të përshtatshme që mundësojnë:

- **Përgjegjësinë** e një bordi mbikëqyrës ndaj palëve të interesit për mbikëqyrje organizative përmes integritetit, udhëheqjes dhe transparencës.
- **Veprimet** (përfshirë administrimin e riskut) nga drejtimi i lartë për të arritur objektivat e organizatës përmes vendimmarrjes së bazuar në risk dhe përdorimit të burimeve.
- **Siguri dhe këshilla** nga një funksion i pavarur i auditimit të brendshëm që siguron qartësi dhe besim dhe promovon e lehtëson përmirësimin e vazhdueshëm përmes kërkesave rigorozë, komunikimit dhe njohurive të thelluara.

Termet kryesore

Vendimmarrja e bazuar në risk - Një proces i mirëmenduar që përfshin analizën, planifikimin, veprimin, monitorimin dhe rishikimin, dhe merr parasysh ndikimet e mundshme të pasigurisë mbi objektivat.

Siguria – Konfirmim dhe besim i pavarur.

Parimi 2: Rolet e Bordit Mbikëqyrës

Bordi mbikëqyrës siguron që:

- Strukturat dhe proceset e duhura janë ndërtuar për një qeverisje efektive.
- Objektivat dhe aktivitetet organizative janë në përputhje me interesat kryesore të palëve të interesit.

Bordi mbikëqyrës:

- Delegon përgjegjësinë dhe siguron burime për drejtimin e lartë për të arritur objektivat e organizatës duke siguruar që të përmbushen pritshmëritë ligjore, rregullative dhe etike.
- Krijon dhe mbikëqyr një funksion të pavarur, objektiv dhe kompetent të auditimit të brendshëm për të siguruar qartësi dhe besim në progresin drejt arritjes së objektivave.

Parimi 3: Rolet e Drejtimit të Lartë dhe të linjës së parë dhe të dytë

Përgjegjësia e drejtimit të lartë për të arritur objektivat organizative përfshin rolet e linjës së parë dhe të dytë.¹ *Rolet e linjës së parë* lidhen drejtpërdrejt me ofrimin e produkteve dhe / ose shërbimeve të klientëve të organizatës, dhe përfshijnë edhe rolet e funksioneve mbështetëse.² *Rolet e linjës së dytë* ofrojnë ndihmë për administrimin e riskut.

Rolet e linjës së parë dhe të dytë mund të bashkohen ose ndahen. Disa role të linjës së dytë mund t'u caktohen specialistëve që sigurojnë ekspertizë plotësuese, mbështetje, monitorim dhe sfidë për specialistët e linjës së parë. Rolet e linjës së dytë mund të përqëndrohen në objektiva specifike të administrimit të riskut, siç janë: përputhshmëria me ligjet, rregulloret dhe sjelljen e pranueshme etike; kontrolli i brendshëm; siguria e informacionit dhe teknologjisë; qëndrueshmëria; dhe sigurimi i cilësisë. Në mënyrë alternative, rolet e linjës së dytë mund të përfshijnë një përgjegjësi më të gjerë për administrimin e riskut, siç është administrimi i riskut të ndërmarrjes (ERM – Enterprise Risk Management). Sidoqoftë, përgjegjësia për administrimin e riskut mbetet një pjesë e roleve të linjës së parë dhe brenda fushës së administrimit.

Parimi 4: Rolet e linjës së tretë

Auditimi i brendshëm ofron siguri të pavarur dhe objektive dhe këshilla mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e qeverisjes dhe administrimit të riskut.³ Ai e realizon këtë përmes zbatimit kompetent të proceseve sistematike dhe të disiplinuar, ekspertizës dhe gjykimit të thelluar. Ai raporton gjetjet e tij tek Drejtimi i Lartë dhe bordi mbikëqyrës për të nxitur dhe lehtësuar përmirësimin e vazhdueshëm. Gjatë punës së tij, ai mund të konsiderojë sigurinë e dhënë nga ofruesit e tjerë të brendshëm dhe të jashtëm.

Parimi 5: Pavarësia e linjës së tretë

Pavarësia e auditimit të brendshëm nga përgjegjësitë e drejtimit të lartë është kritike për objektivitetin, autoritetin dhe besueshmërinë e tij. Ajo përcaktohet përmes: llogaridhënies para bordit mbikëqyrës; aksesit të pakufizuar tek njerëzit, burimet dhe të dhënat e nevojshme për të kryer punën e tij; dhe lirisë nga paragjykimet ose nga ndërhyrja në planifikimin dhe dorëzimin e shërbimeve të auditimit.

Parimi 6: Krijimi dhe mbrojtja e vlerës


Të gjitha rolet duke punuar së bashku dhe kolektivisht kontribuojnë në krijimin dhe mbrojtjen e vlerës kur ato janë në përputhje me njëra-tjetrën dhe me interesat kryesore të palëve të interesit. Përafrimi i aktiviteteve kryhet përmes komunikimit, bashkëpunimit dhe bashkërendimit. Kjo siguron besueshmërinë, koherencën dhe transparencën e informacionit të nevojshëm për një vendimarrje të bazuar në risk.

1. Termat "linja e parë," "linja e dytë," dhe "linja e tretë" janë ruajtur nga modeli origjinal për arsye të familjaritetit. Gjithsesi, "linjat" nuk synojnë të tregojnë elementet strukturore por një ndarje të dobishme të roleve. Llogjikisht, rolet e bordit mbikëqyrës përbëjnë gjithashtu një "linjë" por kjo ndarje nuk është futur për të shmangur konfuzionin. Radhitja (e para, e dyta, e treta) nuk nënkupton operacione të njëpasnjëshme. Por, të gjitha rolet veprojnë njëkohësisht.

2. Disa i konsiderojnë rolet e funksioneve mbështetëse (të tilla si Burimet Njerëzore, shërbimet e administratës dhe të mirëmbajtjes) si role të linjës së dytë. Për qartësi, Modeli i Tre Linjave përcakton që *rolet e linjës së parë* përfshijnë aktivitetet si në "zyrat e linjës së parë" (Front office) ashtu dhe në "zyrat e linjës së dytë" (Back office), dhe *rolet e linjës së dytë* përfshijnë ato aktivitete plotësuese të përqendruara në çështje të lidhura me riskun.

3. Në disa organizata, identifikohen role të tjera të linjës së tretë, të tilla si mbikëqyrja, inspektimi, hetimi, vlerësimi dhe rregullimi, të cilat mund të jenë pjesë e funksionit të auditimit të brendshëm ose të veprojnë më vete.

Modeli i Tre Linjave të IIA



KYC: ↑ Përgjegjësi, raportim

↓ Delegim, drejtim, burime, mbikëqyrje

↔ Përafrim, komunikim, koordinim, bashkëpunim

ROLET KRYESORE NË MODELIN E TRE LINJAVE

Organizatrat ndryshojnë shumë në shpërndarjen e përgjegjësisë. Sidoqoftë, rolet e niveleve të larta që janë përshkruar më poshtë shërbejnë për të plotësuar Parimet e Modelit të Tre Linjave.

Bordi Mbikëqyrës

- Pranon përgjegjësinë ndaj palëve të interesit për mbikëqyrjen e organizatës.
- Angazhohet me palët e interesit për të monitoruar interesat e tyre dhe komunikon në mënyrë transparente në lidhje me arritjen e objektivave.
- Ushqen një kulturë që promovon sjellje etike dhe përgjegjësi.
- Krijon strukturat dhe proceset për qeverisjen, përfshirë komitetet ndihmëse sipas nevojave.
- Deleton përgjegjësinë dhe siguron burime për drejtimin e lartë për arritjen e objektivave të organizatës.
- Përcakton oreksin për risk të organizatës dhe ushtron mbikëqyrje të administrimit të riskut (përfshirë kontrollin e brendshëm).
- Kujdeset për mbikëqyrjen e përputhshmërisë me kërkesat ligjore, rregullative dhe etike.
- Themelon dhe mbikëqyr një funksion të pavarur, objektiv dhe kompetent të auditimit të brendshëm.

Drejtimi i lartë

Rolet e linjës së parë

- Udhëheq dhe drejton veprimet (përfshirë administrimin e riskut) dhe aplikimin e burimeve për të arritur objektivat e organizatës.
 - Mban një dialog të vazhdueshëm me bordin mbikëqyrës dhe raporton për: rezultatet e planifikuara, aktuale dhe të pritshme të lidhura me objektivat e organizatës si dhe për riskun.
 - Vendos dhe mirëmban strukturat dhe proceset e duhura për administrimin e operacioneve dhe riskut (përfshirë kontrollin e brendshëm).
 - Siguron përputhshmëri me kërkesat ligjore, rregullative dhe etike.
-

Rolet e linjës së dytë

- Sigurojnë ekspertizë plotësuese, mbështetje, monitorim dhe sfidë në lidhje me administrimin e riskut, duke përfshirë:
 - Zhvillimin, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të administrimit të riskut (përfshirë kontrollin e brendshëm) në nivel procesesh, sistemesh dhe njësie.
 - Arritjen e objektivave të administrimit të riskut, siç janë: përputhshmëria me ligjet, rregulloret dhe sjelljen e pranueshme etike; kontrolli i brendshëm; siguria e informacionit dhe teknologjisë; qëndrueshmëria; dhe sigurimi i cilësisë.
- Siguron analiza dhe raporte mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e administrimit të riskut (përfshirë kontrollin e brendshëm).

Auditimi i brendshëm

- Mban përgjegjësinë primare përpara bordit mbikëqyrës dhe ruan pavarësinë nga përgjegjësitë e drejtimin të lartë.
- Komunikon siguri të pavarur dhe objektive dhe këshilla për drejtimin e lartë dhe bordin mbikëqyrës mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e qeverisjes dhe administrimit të riskut (përfshirë kontrollin e brendshëm) për të mbështetur arritjen e objektivave organizative dhe për të nxitur dhe lehtësuar përmirësimin e vazhdueshëm.
- Raporton cënimet e pavarësisë dhe objektivitetit tek bordi mbikëqyrës dhe zbaton masat ruajtëse siç kërkohet.

Ofrues të jashtëm të sigurisë

- Ofrjnë siguri shtesë për të:
 - Përbushur kërkesat ligjore dhe rregullative që shërbejnë për të mbrojtur interesat e palëve të interesit.
 - Përbushur kërkesat nga drejtimi i lartë dhe bordi mbikëqyrës për të plotësuar burimet e brendshme që ofrojnë siguri.

Marrëdhëniet ndërmjet roleve kryesore

Ndërmjet bordit mbikëqyrës dhe drejtimit të lartë (si rolet e linjës së parë ashtu edhe të linjës së dytë)

Bordi mbikëqyrës zakonisht përcakton drejtimin e organizatës duke përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe oreksin e organizatës për riskun. Ai delegon më pas përgjegjësi për arritjen e objektivave të organizatës tek drejtimi i lartë, së bashku me burimet e nevojshme. Bordi mbikëqyrës merr raporte nga drejtimi i lartë për rezultatet e planifikuara, aktuale dhe të pritshme, si dhe raporte për riskun dhe administrimin e tij.

Term Kyç

Drejtori Ekzekutiv – Individu me detyrën më të lartë në organizatë mbi operacionet

Organizatat variojnë për sa i përket shkallës së mbivendosjes dhe ndarjes së detyrave midis bordit mbikëqyrës dhe drejtimit të lartë. Bordi mbikëqyrës përfshihet kryesisht në çështjet strategjike dhe operacionale. Bordi mbikëqyrës ose drejtimi i lartë mund të udhëheqin në zhvillimin e planit strategjik, ose mund të jetë një sipërmarrje e përbashkët. Në disa juridiksione, drejtori ekzekutiv⁴ mund të jetë anëtar i bordit mbikëqyrës madje edhe kryetari i këtij organi. Në të gjitha rastet, midis drejtimit të lartë dhe bordit mbikëqyrës duhet të ketë komunikim të mirë dhe të vazhdueshëm. Drejtori Ekzekutiv është zakonisht hallka kyçe për këtë komunikim, por edhe drejtues të tjerë të lartë mund të kenë komunikim të shpeshtë me bordin mbikëqyrës. Organizatat mund të zgjedhin, dhe rregullatorët e tyre mund të kërkojnë që, udhëheqësit e roleve të linjës së dytë si Drejtuesi i Departamentit të Riskut, Drejtuesi i Departamentit të Përputhshmërisë të kenë linjë raportimi të drejtpërdrejtë me bordin mbikëqyrës. Kjo është plotësisht në përputhje me Parimet e Modelit të Tre Linjave.

Ndërmjet drejtimit të lartë (si rolet e linjës së parë ashtu edhe të dytë) dhe auditimit të brendshëm

Pavarësia e auditimit të brendshëm nga drejtimi i lartë siguron që auditimi i brendshëm të jetë i lirë nga cënimi dhe paragjykimi në planifikimin dhe në kryerjen e punës, duke gëzuar akses të pakufizuar tek njerëzit, burimet dhe informacioni që kërkon. Ai jep llogari tek bordi mbikëqyrës. Sidoqoftë, pavarësia nuk nënkupton izolim. Duhet të ketë një komunikim të rregullt ndërmjet auditimit të brendshëm dhe drejtimit të lartë për të siguruar që puna e auditimit të brendshëm është e përshtatshme dhe në linjë me nevojat strategjike dhe operative të organizatës. Nëpërmjet të gjitha aktiviteteve të tij, auditimi i brendshëm mbledh të dhënat dhe krijon njohuritë dhe kuptueshmërinë e tij për organizatën, të cilat kontribuojnë në siguridhënien dhe këshillimin që jep si një

⁴ Termi Drejtor Ekzekutiv është përshtatur nga anglishtja dhe i referohet termit Chief Executive Officer - CEO

këshilltar i besuar dhe partner strategjik. Eshhtë i nevojshëm bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet dy linjave të drejtimit të parës dhe të dytës dhe auditimit të brendshëm për të siguruar që nuk ka dublikime, mbivendosje ose boshllëqe të panevojshme.

Midis auditimit të brendshëm dhe bordit mbikëqyrës

Auditimi i brendshëm është përgjegjës ndaj, dhe ndonjëherë përshkruhet si "sytë dhe veshët" e bordit mbikëqyrës.

Bordi mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen e auditimit të brendshëm, detyrë e cila kërkon: sigurimin e një funksioni të pavarur të auditimit të brendshëm, duke përfshirë punësimin dhe shkarkimin e Drejtuesit të Auditimit të Brendshëm (DAB); duke shërbyer si linja kryesore e raportimit për DAB⁵; miratimin dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për planin e auditimit; marrjen dhe shqyrtimin e raporteve nga DAB; dhe mundësimin e kontaktimit të lirë nga DAB drejt bordit mbikëqyrës, përfshirë takimet private pa praninë e drejtimit të lartë.

Term Kyç

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm (DAB) – Individ i me detyrën më të lartë në organizatë për shërbimet e auditimit të brendshëm

Midis gjithë roleve

Bordi mbikëqyrës, drejtimi i lartë dhe auditimi i brendshëm kanë përgjegjësitë e tyre të ndryshme, por të gjitha aktivitetet duhet të jenë në përputhje me objektivat e organizatës. Baza për një koherencë të suksesshme janë koordinimi periodik dhe i efektshëm, bashkëpunimi dhe komunikimi.

⁵ Për arsye raportimi administrativ DAB mund të raportojë edhe tek një nivel i lartë, i përshtatshëm drejtues.

VËNIA NË ZBATIM E MODELIT

Struktura, rolet dhe përgjegjësitë

Modeli i Tre Linjave është më efektiv kur është i përshtatur me objektivat dhe rrethanat e organizatës. Mënyra se si strukturohet një organizatë dhe si caktohen rolet, janë vendime që i merr drejtimi i lartë dhe bordi mbikëqyrës. Bordi mbikëqyrës mund të krijojë komitete për të siguruar mbikëqyrje shtesë për aspekte specifike të përgjegjësisë së tij, të tilla si auditimi, risku, financat, planifikimi dhe kompensimi. Brenda drejtimit të lartë, ka të ngjarë të ketë përshtatje funksionale dhe hierarkike dhe, ndërkohë që organizatat rriten nga madhësia dhe kompleksiteti, ka një tendencë në rritje drejt specializimit.

Funksione, ekipe, madje edhe individë mund të kenë përgjegjësi që përfshijnë rolet e linjës së parë dhe të dytë. Sidoqoftë, drejtimi dhe mbikëqyrja e roleve të linjës së dytë mund të projektohen për të siguruar një shkallë të caktuar pavarësie nga rolet e linjës së parë - dhe madje edhe nga nivelet më të larta të drejtimit - duke siguruar llogaridhënien dhe linjat e raportimit kryesisht tek bordi mbikëqyrës. Modeli i Tre Linjave lejon atë linja raportimi ndërmjet drejtimit të lartë dhe bordit mbikëqyrës sa të jetë e nevojshme. Në disa organizata, më së shumti institucionet financiare të mirë rregulluara, është një kërkesë e detyrueshme për të tilla projekte në mënyrë që të sigurohet mjaftueshëm pavarësi. Edhe në situata të tilla, drejtimi i lartë i linjës së parë mbetet përgjegjës për administrimin e riskut.

Rolet e linjës së dytë mund të përfshijnë monitorimin, këshillimin, udhëzimin, testimin, analizimin dhe raportimin e çështjeve që lidhen me administrimin e riskut. Për atë kohë sa ato ofrojnë mbështetje dhe sfidojnë rolet e linjës së parë, si dhe janë pjesë integrale e vendimeve dhe veprimeve të drejtimit të lartë, rolet e linjës së dytë janë pjesë e përgjegjësisë së drejtimit të lartë dhe kurrë nuk janë plotësisht të pavarura nga ai, pavarësisht nga linjat e raportimit dhe përgjegjësitë.

Një karakteristikë përcaktuese e roleve të linjës së tretë është pavarësia nga drejtimi i lartë. Parimet e Modelit të Tre Linjave përshkruajnë rëndësinë dhe natyrën e pavarësisë së auditimit të brendshëm, duke veçuar auditimin e brendshëm nga funksionet e tjera dhe duke mundësuar vlerën dalluese të siguridhënies dhe këshillimit të tij. Pavarësia e auditimit të brendshëm ruhet duke mos marrë vendime ose ndërmarrë veprime që janë pjesë e përgjegjësisë së drejtimit të lartë (përfshirë administrimin e riskut) dhe duke refuzuar të japë siguri në aktivitetet për të cilat auditimi i brendshëm ka pasur së fundmi përgjegjësi ose ka aktualisht përgjegjësi.

Për shembull, në disa organizata, drejtuesit të auditimit të brendshëm (DAB) i kërkohet të marrë përgjegjësi shtesë në lidhje me vendimmarrjen mbi aktivitete që kanë kompetenca të ngjashme, të tilla si aspektet e përputhshmërisë ligjore ose mbi administrimin e riskut të organizatës (ERM). Në rrethana të tilla, auditimi i brendshëm nuk është i pavarur nga këto aktivitete ose nga rezultatet e tyre, dhe për këtë arsye, kur bordi mbikëqyrës kërkon siguridhënie dhe këshillim të paanshëm dhe objektiv, është e nevojshme që ky aktivitet të ndërmerret nga një palë e tretë e kualifikuar.

Mbikëqyrja dhe siguridhënia

Bordi mbikëqyrës mbështetet në raportet nga drejtimi i lartë (duke përfshirë ato me role të linjës së parë dhe të dytë), nga auditimi i brendshëm dhe të tjerë në organizatë, në mënyrë që të mbikëqyrë dhe të arrijë objektivat e tij, për të cilat është përgjegjës para palëve të interesit. Drejtimi i lartë ofron një siguri të vlefshme (ose quajtur ndryshe çertifikim) për rezultatet e planifikuara, aktuale dhe të pritura, për riskun dhe për administrimin e tij duke u mbështetur në përvojën dhe ekspertizën e drejtpërdrejtë. Drejtuesit me role të linjës së dytë ofrojnë siguri shtesë për çështje të lidhura me riskun. Për shkak të pavarësisë së auditimit të brendshëm nga drejtimi i lartë, siguria që ai ofron mbart shkallën më të lartë të objektivitetit dhe besimit përtej asaj që drejtuesit me role në linjën e parë dhe të dytë mund t'i ofrojnë bordit mbikëqyrës, pavarësisht linjave të raportimit. Siguridhënia e mëtejshme mund të merret edhe nga ofruesit e jashtëm.

Koordinimi dhe përafrimi

Një qeverisje efektive kërkon caktimin e duhur të përgjegjësive, si dhe harmonizimin e aktiviteteve përmes bashkëpunimit dhe komunikimit. Bordi mbikëqyrës përmes auditimit të brendshëm kërkon konfirmimin që strukturat drejtuese dhe proceset janë të konceptuara në mënyrën e duhur dhe funksionojnë sipas synimeve të organizatës.

Rreth IIA

Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) është avokati, edukatori dhe ofruesi i standardeve, udhëzimeve dhe çertifikimeve më të njohura të profesionit të auditimit të brendshëm. Themeluar në 1941, IIA sot i shërben më shumë se 200,000 anëtarëve nga më shumë se 170 vende dhe territore. Selia e shoqatës ndodhet në adresën Lake Mary, Fla., USA. Për më shumë informacion, vizitoni www.globalia.org.

Deklarata e përgjegjësisë

IIA boton këtë dokument për qëllime informative dhe edukative. Ky material nuk ka për qëllim të ofrojë përgjigje përfundimtare për rrethanat specifike individuale dhe si i tillë synon të përdoret vetëm si udhëzues. IIA rekomandon këshillim të pavarur të ekspertëve që lidhen drejtpërdrejt me ndonjë situatë specifike. IIA nuk ka asnjë përgjegjësi ndaj askujt që mbështetet vetëm në këtë material.

E drejta e autorit

Copyright © 2020 The Institute of Internal Auditors, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Për lejen në rast riprodhimi, ju lutemi të kontaktoni copyright@theiia.org.

Korrik 2020